



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Received	11 - 12	2018	8
Organ / Detyra / Org. Unit	SKPM SHCK	7568/2018	11
Organ / Detyra / Org. Unit	SKPM SHCK	7568/2018	11
Organ / Detyra / Org. Unit	SKPM SHCK	7568/2018	11
Organ / Detyra / Org. Unit	SKPM SHCK	7568/2018	11



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 338 /2018

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit.
2. Obligohet Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:

- Kryesuesit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Menaxherit të Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit






REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Prishte / Prishtine Prishtine / Prishtine Prishtine / Prishtine	11 - 12	8	Viti Year
Organizimi / Organizacija Organization / Organizacija Org / Org	SKPM SHCK	7568/2018	Kopje Quantity
			1110



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA

INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORT I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE

PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

ORGANIN SHQYRTUES TË PROKURIMIT

PËR VITIN

2017

Prishtinë, 2018

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Mbikëqyrjes.....	3
Objektiva dhe metodologjia e mbikëqyrjes.....	3
Fushat e mbikëqyrjes.....	4
Raporti për mbikëqyrjen në Organin Shqyrtues të Prokurimit.....	5
Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve.....	6
Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit.....	6
Procedurat disiplinore.....	7
Procedurat e ankesave.....	7
Procedurat e vlerësimit.....	7
Procedurat e pushimeve.....	7
Procedurat e transferimit.....	8
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara.....	8
Pezullimi, ndërprerja dhe përfundimi i marrëdhënies së punës.....	8
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	8
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	9
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	9
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	9
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	10
Shënimet/komentet për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	10

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI I KËSHILLIT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes, Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil nga institucionet e administratës publike të nivelit qendror dhe lokal.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar „Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton „Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim të vitit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë, duke u bazuar në „Pyetësin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil” kemi kryer monitorimin duke zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit për shërbimin civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë zbatimit të mandatit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të institucioneve, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil.

Në këtë kuadër, si pjesë e mbikëqyrjes janë përfshirë fushat:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË ORGANIN SHQYRTUES TE PROKURIMIT PËR VITIN 2017

Kolegji, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Organin Shqyrtues të Prokurimit, për të vlerësuar drejtë, në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 06.02.2018, në prezencë të Udhëheqëses të Personelit, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Evidenca e trajnimeve të ndjekura nga zyrtarët e OSHP për vitin 2017 (brenda vendit),
- Evidenca e trajnimeve të ndjekura nga zyrtarët e OSHP për vitin 2017 (jashtë vendit),
- Kërkesa për trajnim e datës 13.04.2017,
- Ftesa për trajnim e datës 15.06.2017, 26.05.2017, 18.05.2017, 25.04.2017, 02.03.2017,
- Plani individual i trajnimeve të datës 30.01.2017,
- Vendimin për lejimin e udhëtimit zyrtar të datës 15.11.2017,
- Kërkesa për trajnim të zyrtarëve të OSHP-së e datës 15.11.2017,
- Vendimi mbi lejimin e udhëtimit zyrtar i datës 24.11.2017,
- Kërkesa për trajnim të zyrtarëve të OSHP-së i datës 24.11.2017,
- Kërkesa për trajnim e datës 24.11.2017,
- Klasifikimi i aprovuar nga MAP i datës 04.07.2016,
- Evidenca e pushimeve mjekësore për vitin 2017,
- Vendimi i datës 21.11.2016 për formimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave,
- Vendimi për pezullim parandalues i datës 03.05.2016,
- Urdhër pagesë për paga dhe shtesa e datës 29.11.2017,
- Organogrami i Organit shqyrtues të prokurimit,
- Plani vjetor i trajnimeve për vitin 2017 i datës 03.02.2017,
- Vendimi mbi caktimin e pozitave shtesë për zyrtarët e datës 20.01.2016,
- Kërkesa për transferim e datës 24.11.2017,
- Marrëveshja për transferim e datës 04.12.2017,
- Vendim për lejimin e pushimit të lehonisë i datës 31.10.2016,
- Vendimi mbi shqiptimin e masës disiplinore i datës 30.11.2017;
- Vendimi i komisionit disiplinor i datës 10.11.2017;
- Vendimi i Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave i datës 18.07.2017;
- Vendimi i komisionit disiplinore i datës 22.06.2017;
- Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e kontesteve dhe Ankesave i datës 25.05.2017;
- Marrëveshja për shërbime të veçanta e datës 23.10.2017;
- Marrëveshja për shërbime të veçanta e datës 24.01.2018;
- Marrëveshja për shërbime të veçanta e datës 23.10.2017;
- Marrëveshja për shërbime të veçanta e datës 24.07.2017;
- Vendimi për caktimin e UD për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Brendshëm në OSHP datës 04.12.2017,
- Vendimi për formimin e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave i datës 01.02.2018,
- Vendimi për formimin e komisionit disiplinor i datës 21.11.2016,
- Konkursi publik për marrëveshje për shërbime të veçanta i datës 02.10.2017.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në pyetësin për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar të gjeturat në vijim të raportit, si dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si në vijim:

1. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës në Organin Shqyrtues të Prokurimit, me datë 06.02.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe që është duke e zbatuar të njëjtën. Poashtu edhe Akt Emërimet e nëpunësve civil janë në pajtim me këtë rregullore. Sipas deklaratimit të zyrtarës së personelit, në këtë institucion janë të punësuar 18 nëpunës civil.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar tri (3) dosje të nëpunësve civil, dhe ka konstatuar që të gjitha dosjet e nëpunësve civil janë të kompletuara sipas legjislacionit përkatës.

Në bazë të informatave të ofruara, është konstatuar që Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pasur një (1) nëpunës të caktuar si ushtrues të detyrës me Vendimin me nr.1093/17 të datës 04.12.2017 për caktimin e ushtruesit të detyrës në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Brendshëm.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, gjatë vitit 2017 nuk ka zhvilluar asnjë procedurë të rekrutimit, me përjashtim të tri procedurave të rekrutimit me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Pas shqyrtimit të dosjeve për pozitën „zyrtar për përkthim” për pozitën „asistent administrativ i kryetarit” dhe për pozitën “Zyrtare Administrative”. Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar që për këto pozita është zhvilluar procedurë e thjeshtë e rekrutimit sipas Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

E GJETURA 1: Kolegji për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, për vitin 2017 ka pasur të angazhuar gjithsej 3 nëpunës me marrëveshje për shërbime të veçanta, prej të cilëve 3 pozitat për të cilat janë angazhuar këta nëpunës, kanë qenë pozita të nëpunësve civilë. Kolegji si mostër ka marrë marrëveshjet për shërbime të veçanta për të gjitha pozitat e lartëcekura.

Kolegji ka konstatuar, që në bazë të nenit 12 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy kategori të të punësuarëve: „pozitat e nëpunësve civilë të karrierës dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës”.

Në kuptim të kësaj dispozite, pozitat e nëpunësve civil të karrierës apo të jo karrierës, nuk mund të plotësohen me nëpunës me kontrata për marrëveshje për shërbime të veçanta.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryesuesin e Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Udhëheqësen e Personelit, që të ndërmarrin veprimet për eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe që për pozitat e nëpunësve civil, të mos angazhojnë nëpunës në bazë të kontratave për shërbime të veçanta por që plotësimi i vendeve të lira të punës të caktuara për nëpunës civil të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të Vendimit me numër 977/16 të datës 21.11.2016 për emërimin e Komisionit Disiplinor, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, Komisionin Disiplinor e ka themeluar në pajtim me dispozitat e nenit 70 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në këtë institucion janë iniciuar pesë (5) raste në komision disiplinor ndaj nëpunësve civil. Në Këshill gjatë vitit 2017 kemi pas vetëm një ankesë, të cilën Këshilli e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të Vendimit me numër 976/16 të datës 21.11.2016 për emërimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, e ka themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civil dhe nuk ka pasur nëpunës civil që nuk është vlerësuar.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se vlerësimi i punës është bërë në pajtim me nenin 10 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Organi Shqyrtues të Prokurimit, evidenca e pushimeve të nëpunësve civil mbahet në kopje fizike. Gjithsejt 12 nëpunës civil kanë realizuar pushimin mjekësor, dhe në bazë të dosjeve të kontrolluara, konstatohet që nëpunësit civil kanë sjell dëshmitë mjekësore ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Kolegji ka konstatuar se një (1) nëpunës civil ka realizuar pushim prindor-lehonisë, dhe në bazë të vendimit për shfrytëzimin e pushimit prindor-lehonisë është konstatuar që pushimet e lehonisë janë miratuar në pajtim me legjislacionin përkatës për pushimin e lehonisë.

Poashtu është konstatuar që dy (2) nëpunës civilë kanë realizuar pushimin pa pagesë.

Për këtë fushë të mbikqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ka pasur një transferim të përhershëm të nëpunësit civil.

Pasi është analizuar dosja e transferimit, është konstatuar se transferimi është bërë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka të punësuar 18 nëpunës civil, që janë shqiptar.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 18 nëpunësve civil të punësuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, 11 nëpunës janë meshkuj, ndërsa 7 nëpunëse të punësuar janë femra, që nënkupton se nuk ka numër të të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryesuesin e Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Udhëheqësen e Personelit, që të ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, gjatë vitit 2016 ka pasur një rast të pezullimit parandalues i cili vazhdon të jetë i pezulluar nga puna deri në vendimin e Gjykatës kompetente.

Kolegji ka shqyrtuar dosjen e nëpunësit civil dhe ka konstatuar se për të procedura është ndjekur në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të informatave të pranuar nga zyrtarët e personelit, ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, nuk ka pasur asnjë nëpunës civil i cili është duke e mbajtur pozitën e nëpunësit civil dhe poashtu në të njëjtën kohë është duke e ushtruar detyrën e funksionarit publik.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, në bazë të informatave të pranura nga zyrtarja e personelit, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, nga viti 2016 ka një nëpunës civil në pezullim parandalues. Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 27.04.2016 është njoftuar, se ndaj nëpunësit civil-ekspertit shqyrtues është ngritur aktakuzë. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerr vendimin me nr.261/16 të datës 03.05.2016 për pezullim parandalues deri në një vendim të Gjykatës Kompetente.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, Plani i trajnimeve është përgatitur dhe proceduar në DASHC/MAP me datë 03.02.2017.

Në bazë të dëshmive të ofruara, konstatohet që në trajnime kanë marr pjesë dyzetë (40) nëpunës civil, prej të cilëve, katërmëdhjetë (14) nëpunës, kanë vijuar trajnimet jashtë vendit.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Plani i trajnimeve është përgatitur në kundërshtim me afatin e përcaktuar me dispozitat e nenit 16 të Rregullores Nr. 19/2012 për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil.

REKOMANDIMI 1:

Rekomandojmë Kryesuesin e Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Udhëheqësen e Personelit, që me rastin e përgatitjes së planit të trajnimeve të nëpunësve, të respektojnë afatet dhe procedurat e përcaktuara me dispozitat e nenit 16 të Rregullores Nr. 19/2012 për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil.

13. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Organin Shqyrtues të Prokurimit, evidenca e vijimit në punë mbahet në formë elektronike. Pagat e nëpunësve civil janë në pajtim me Akt Emërimet. Nëpunësit civil realizojnë shtesë për teknologji informative.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

14. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në vitin 2017 nuk ka bërë vizitë monitoruese në Organin Shqyrtues të Prokurimit

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit, i ka zbatuar rekomandimet e Këshillit, të dhëna në vitin 2016 për vitin 2015.

Lidhur me Vendimet e Këshillit, është konstatuar që Organi Shqyrtues i Prokurimit, po ashtu ka zbatuar vendimet e Këshillit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

15. SHËNIMET/KOMENTET PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe inspektimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikëqyrjes për vitin 2017 në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ka konstatuar tri (3) të gjetura dhe ka dhënë tri (3) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, që të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lulzim ALIAJ
Kryetar i Kolegjit

Zyle GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Raporti i dërgohet:

- Kryesuesit të Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Menaxherit të Personelit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- Arkivit të KPMSHCK.